



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**

Nr. 84 Prot.

Datë 06.01.2025

**UDHËZIM I PËRGJITHSHËM**

**Nr.8, dt.06.01.2025**

**Mbi rregullshmërinë e përpilimit të akteve procedurale dhe administrative**

Mbështetur në ligjin nr. 97/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.7905, dt.21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar, ligjin nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, infomimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan,

Me qëllim :

- *Forcimin e rregullshmërisë administrative në veprimtarinë e prokurorisë ;*

- *Kontrollin dhe garantimin e korrektësisë, qartësisë dhe rregullshmërisë në përpilimin, printimin, miratimin, shpërndarjen, ruajtjen dhe administrimin e akteve shkresore ;*
- *Formalizimin dhe dokumentimin e vullnetit të zyrtarit përgjegjës mbi efektin e akteve të organit të prokurorisë ;*
- *Administrimin e rregullt të drejtësisë penale ;*
- *Saktësimin e mënyrës së veprimit nga oficeri i policisë gjyqësore, prokurori, zyrtari administrativ dhe/ose subjekti titullar i prokurorisë përsa i takon përpilimit të shkresave/akteve ;*
- *Evidentimin e personit përgjegjës në rast situatë problematike ;*

#### UDHËZOJ :

1. Shkresat që përcjellin një akt procedural apo administrativ si dhe të gjitha shkresat e tjera me natyrë procedurale ose administrative që prodhohen në kuadër të veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, duhet të përmbajnë :
  - a. Në të gjitha ekzemplarët original në pjesën e sipërme majtas, pas numrit të protokollit, inicialet e zyrtarit përpilues.
  - b. Në ekzemplarin e shkresës që ruhet/administrohet në institucion, në pjesën e poshtme majtas duhet të shënohen në formatin Times New Roman, front size 10:
    - i. Konceptoi : (emri dhe mbiemri i zyrtarit konceptues së bashku me nënshkrimin e tij)
    - ii. Miratoi : (emri dhe mbiemri i zyrtarit miratues së bashku me nënshkrimin e tij)
    - iii. Numri i kopjeve
    - iv. Data e printimit të shkresës
2. Drejtuesi i Prokurorisë, Zv.Drejtuesi i Prokurorisë, Drejtuesit e Seksioneve dhe Kancelari për shkresat që përpilojnë, konceptojnë, miratojnë dhe nënshkruajnë vet në kuadër të veprimtarisë së tyre procedurale ose administrative, përjashtohen nga detyrimi që përcaktohet në pikën nr.1/b të mësipërme.
3. Prokurorët për shkresat që përpilojnë, konceptojnë, miratojnë dhe nënshkruajnë vet në kuadër të veprimtarisë së tyre procedurale ose administrative, sipas urdhërave të

Drejtuesit të Prokurorisë me anë të së cilave i'u delegohet kompetenca dhe nënshkrimi, përjashtohen nga detyrimi që përcaktohet në pikën nr.1/b të mësipërme.

4. Me këtë udhëzim të njihen prokurorët dhe oficerët e kësaj prokurorie, kancelarja dhe punonjësit administrativ. Një kopje e këtij urdhëri i'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti TI-së me kryerjen e njoftimit.
5. Kopje e këtij udhëzimi të dërgohet për njohje dhe zbatim pranë shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, të Komisariateve të Policisë Elbasan, Librazhd, Cërrik, Peqin dhe Gramsh, AMP Elbasan, Drejtorinë e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve Tiranë, si dhe Seksionin e Policisë Ushtarake Elbasan.
6. Ky udhëzim hyn në fuqi më datë 13.01.2025 dhe publikohet në faqen zyrtare web të Prokurorisë së Përgjithshme.

**DREJTUES I PROKURORISË**

**Kreshnik AJAZI**

